



Menaxhimi i Mbeturinave në Prizren



MENAXHIMI I MBETURINAVE NË PRIZREN

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe

Adresa: Rr. Fehmi Lladrovci 94,
Prizren, Bulevardi Nënë Tereza, H 30
B1 Nr.5, 10000 Prishtinë
Kontakti: www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Hulumtimi "Menaxhimi i mbeturinave në Prizren" është realizuar nga EC Ma Ndryshe, i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, (Sida) përmes Programit të saj "Human Rightivism" që implementohet nga Community Development Fund – CDF.

Përbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtarë të donatorëve.



HYRJA

Hedhja e mbeturinave në mënyrë të pakontrolluar ka ndikime të mëdha në mjedis dhe mund të shkaktojë probleme serioze. Kështu që menaxhimi i mirë i mbeturinave ndikon në zvogëlimin e efektit negativ të tyre në mjedis e shëndet.


Menaxhimi i mbeturinave në vete përfshinë shumë etapa siç janë: mbledhja, transporti, trajtimi, ripërdorimi, përpunimi, riciklimi dhe deponimi përfundimtar i mbeturinës, përfshirë këtu edhe monitorimin dhe kujdesin pas kryerjes së këtyre aktiviteteve, prandaj ky proces duhet të jetë i planifikuar mirë dhe të zbatohet hap pas hapi sepse këto aktivitete edhe nëse kontrollohen dhe realizohen në atë mënyrë, përsëri mund të kenë ndikim negativ në tokë, ujë, ajër, në shëndet të njeriut, mjedisit dhe kualitet të jetës.

EC Ma Ndryshe ka realizuar një hulumtim me anë të anketave mbi gjendjen aktuale të "Menaxhimit të Mbeturinave" në komunën e Prizrenit. Qëllimi i këtij hulumtimit është që të analizohet se si qytetarët e vlersojnë menaxhimin e mbeturinave në qytet, për të kuptuar kështu problematikat dhe shqetësimet me të cilat ata ballafaqohen çdo ditë, në mënyrë që të krijohet një pasqyrë e gjendjes aktuale dhe të rekomandohen disa zgjidhje të mundshme për përmirësim të situatës.

Ky hulumtim është realizuar me 150 persona, nga të cilët 61 ishin gra dhe 89 burra. Lagjet në të cilat është zhvilluar anketa janë këto: Arbanë, Bajram Curr, Bazhdarhane, Bylbyldere, Dardani, Hoçamahallë, Jeni Mahallë, Jeta e Re, Kurillë, Lakuriq, Ortakoll, Petrovë, Qendra Historike, Qoraga, Ralin, Saraçët, Tabahane, Terzimahallë dhe Tusuz.


Për shumë komuna në Kosovë menaxhimi i mbeturinave vazhdon të mbetet sfidë, komunës së Prizrenit i ka skaduar Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave dhe këtë vit është hartuar rregullorja e re (Rregullorja për Menaxhim të Mbeturinave 2021) e cila është në proces të miratimit. Kjo rregullore përcakton çështjen e menaxhimit të mbeturinave komunale, si dhe përcakton vlerën (shumën) e taksës për mbeturina, me qëllim që të krijohet një sistem i qëndrueshëm financiar me cilësi të lartë, dhe ekonomikisht të efektshëm të mbledhjes së mbeturinave komunale në Komunën e Prizrenit, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së mjedisit, menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtja e interesit publik. (<https://bit.ly/3mlC8l2>)

Që ka kuptoni ju me menaxhim të mbeturinave?




- 59%** Mbledhja, ndarja, përpunimi, riciklimi dhe monitorimi i mbeturinave.
- 15%** Mbledhja, përpunimi dhe riciklimi i mbeturinave
- 25%** Grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave
- 1%** Asnjëra nga këto

Si e vlerësoni gjendjen e menaxhimit të mbeturinave në lagjen tuaj?




- 20%** Shumë mirë
- 63%** Mirë
- 17%** Keq

Çfarë probleme mendoni se ekzistojnë në lagjen tuaj mbi menaxhimin e mbeturinave? (Mund të përzgjidhni më shumë se një opsjon)




- 28%** Mungesa e konteinerëve
- 10%** Afati kohor i gjatë i largimit të mbeturinave
- 33%** Mungesa e konteinerëve të ndarë për llojet e ndryshme të mbeturinave
- 8%** Transportimi i mbeturinave
- 15%** Mirëmbajtja e vendeve ku grumbullohen mbeturinat
- 6%** Tjetër

A keni dëgjuar ndonjëherë për rëndësinë e riciklimit?




- 82%** Po
- 18%** Jo


- Nëse hartohet dhe implementohet një program mbi riciklimin e mbetjeve, a jeni ju të gatshëm të ndani mbeturinat sipas llojit dhe ti hudhni ato në shportat përkatëse?




- A mendoni ju se ka nevojë që të organizohen më shumë kampanja vetëdijesuese mbi menaxhimin e mbeturinave?




- Sa jeni ju të shqetësuar për ndotjen e mjedisit nga mbeturinat dhe ndikimin e tyre në gjendjen tuaj shëndetësore?



- A keni vërejtur ndonjëherë deponi ilegale dhe djegie të mbeturinave në hapësira publike?




- Nëse po a keni raportuar ju ndonjë nga rastet e mësipërme në institucionin përkatës?




13% Po kam raportuar
54% Jo nuk kam raportuar
33% Nuk e di ku të raportoj

- A e dini se grumbullimi, transporti dhe deponimi i mbeturinave të vëllimshme (pajisjet elektronike dhe shtëpiake), realizohet nga ana e komunës dy herë në vit pa pagesë; gjatë javës së parë të muajit maj dhe gjatë javës së parë të muajit nëntor?




39% Po
61% Jo, nuk kam informacion

- Sa jeni të kënaqur me tarifat e shërbimeve të mjeteve financiare nga ana e institacioneve përkatëse?



43% Shumë
47% Deri diku
5% Pak
5% Aspak

- A jeni të mendimit se secili individ ka përgjegjësi të kontribuoj në përmirësimin e gjendjes së menaxhimit të mbeturinave?



99% Po
1% Jo

PËRFUNDIME:

Duke u bazuar në statistikat e nxjerra nga ky hulumtim mund të konkludohet se gjendja e menaxhimit të mbeturinave nuk është në nivelin më të mirë të mundshëm, pasiqë në shumicën e lagjeve del se ka mungesë të kontejnerëve dhe shportave për grumbullim të mbeturinave, kjo mungesë është akoma më problematike kur kombinohet me afatin kohor të gjatë të largimit të mbeturinave.

Në të njëjtën kohë ka edhe mungesë të informimit të qytetarëve mbi shërbimet që po i ofrohen nga institucionet dhe mundësitet e tyre për të lajmëruar ndonjë veprim të jashtëligjshëm, siç kemi rastin me deponitë ilegale dhe djegjet në hapësira publike ku duket dukshëm mungesa e informimit të qytetarëve se ku duhet të lajmërojnë këto raste.

- Sa i përket njohurive të qytetarëve mbi termin “menaxhim i mbeturinave” 59.3% e të anketuarve janë përgjigjur se me menaxhim të mbeturinave nënkuqtojnë procesin e mbledhjes, ndarjes, përpunimit, riciklimit dhe monitorimit të mbeturinave, 14.7% kanë thënë se nënkuqtojnë mbledhjen, përpunimin dhe riciklin e mbeturinave, 24.7% mendojnë se menaxhimi ka të bëjë vetëm me grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave ndërsa vetëm 1.3% janë përgjigjur se asnëra nga këto nuk përkojnë me termin menaxhim i mbeturinave.
- Në pyetjen se si e vlerësojnë qytetarët gjendjen e menaxhimit të mbeturinave në lagjet e tyre, 19.3% e qytetarëve janë të mendimit se gjendja është shumë e mirë, 63.3% e tyre mendojnë që është relativisht e mirë dhe 17.3% e tyre e vlerësojnë atë keq.
- Për të pasur një menaxhim të mirëfilltë të mbeturinave duhet eleminuar problemet që e ngadalësojnë këtë proces. Të anketuarit kur janë pyetur se me çfarë probleme hasen në lagjen e tyre janë përgjigjur kështu; 27.7% janë shprehur se në lagjen e tyre ka mungesë të kontejnerëve, 10.4% prej tyre kanë thënë se e shohin si problem afatin kohor të gjatë (një herë në javë) për mbledhjen e mbeturinave, 33.0% të tjerë janë shprehur se mungesa e shportave të ndara për llojet e ndryshme të mbeturinave është një mungesë tjetër në lagjet e tyre, 8.5% si problem cekin edhe transportimin e mbeturinave dhe 14.8% kanë thënë se mirëmbajtja e vendeve ku grumbullohen mbeturinat është një problem shumë shqetësues për ta.

- 82% e të anketuarve kanë potencuar që kanë njojuri për rëndësinë e riciklimit dhe 18% e tyre as nuk kanë dëgjuar më parë për riciklimin.
- Procesi i riciklimit të mbeturinave nuk mund të realizohet nëse qytetarët nuk janë të gatshëm e të informuar se si ti klasifikojnë mbeturinat, prandaj janë pyetur se nëse hartohet dhe implementohet një plan i tillë a janë ata të gatshëm ta zbatojnë atë; e kështu 84% prej tyre kanë potencuar që janë të gatshëm, 14.7% prej tyre janë shprehur se ndoshta dhe vetëm 1.3% kanë thënë që jo nuk janë të gatshëm.
- Promovimi i ngritjes së vetëdijesimit publik- pjesëmarrja aktive e qytetarëve në implementimin e menaxhimit të mbeturinave është një detyrë e çdo komune. Në pyetjen se a ka nevojë të realizohen më shumë kampanja vetëdijesuese mbi këtë çështje, 89.3% e qytetarëve janë shprehur se po kanë nevojë, 6.7% prej tyre kanë thënë ndoshta ndërsa 4% prej tyre u shprehën se nuk ka nevojë.
- 59.3% e të anketuarve janë shumë të shqetësuar për ndotjen e mjedisit nga mbeturinat dhe ndikimin në gjendjen e tyre shëndetësore, 31.3% të tjerë janë deri diku të shqetësuar, 8.7% pak dhe 7% nuk janë fare të shqetësuar.
 - Detyrë tjetër e institucioneve lokale është edhe të identifikoj pikat ilegale (të zeza) të hedhjes mbeturinave dhe largimin e tyre. Mbi këtë çështje 59.3% e qytetarëve potencuan që kanë vërejtur në hapësira publike deponi dhe djegie të mbeturinave; ndërsa 40.7% kanë potencuar që nuk kanë parë. Personat që janë përgjigjur me PO u pyetën se a i kanë rapotuar ato raste, dhe vetëm 8.7% prej tyre u përgjigjën me PO kam raportuar, 36% me JO nuk kam raportuar dhe 22% prej tyre janë shprehur se nuk din ku të raportojnë.
 - Shërbimi pa pagesë nga komuna për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave të vëllimshme bëhet dy herë në vit. Nga 150 të anketuarit vetëm 58 e tyre (38.7%) kishin njojuri për këtë shërbim ndërsa 92 e tyre (61.3%) janë shprehur se nuk kanë informacione.
 - Sa i përket tarifave të mjeteve financiare dhe shërbimeve të institucioneve 42.7% e qytetarëve janë të kënaqur, 47.3% të tjerë janë deri diku të kënaqur, 4.7% janë pak të kënaqur dhe 5.3% nuk janë aspak të kënaqur.
 - 97.7% e qytetarëve të anketuar janë të mendimit se secili individ ka përgjegjësi të kontribuojë në përmirësimin e gjendjes së menaxhimit të mbeturinave ndërsa vetëm 1.3% nuk janë të të njëjtë mendim.

REKOMANDIMET:

Kontejnerët e stërbushur me mbeturina ndikojnë në ndotjen e mjedisit sepse nga ato, mbeturinat shpërndahen nëpër tokë dhe kështu krijohen vende të përshtatshme për zhvillimin e baktereve, për tërheqjen e brejtësve dhe insekteve. Prandaj për t'iu shmangur këtyre dukurive negative duhet të jemi të kujdeshëm dhe të veprojmë në mënyrë më të kujdeshëm. Andaj rekomandohet që të shtohet numri i tyre dhe nëpër zona urbane grumbullimi i mbeturinave të organizohet të paktën dy herë në javë, meqenëse numri i paktë i kontejnerëve dhe koha e gjatë e largimit të mbeturinave ishin ndër shqetësimet dhe kërkosat kryesore të qytetarëve. Promovimi i ngritjes së vetëdijesimit publik është detyrë e institucioneve lokale, por sipas statistikave të këtij hulumtimi shihet se qytetarët nuk janë mjaftueshëm të informuar mbi shumë aspekte të menaxhimit të mbeturinave, shërbimet që i ofron ajo dhe rëndësinë e saj. Kështu që rritja e kampanjave dhe trajnimeve vetëdijesuese mbi këtë aspekt është shumë me rëndësi.

Deponitë ilegale dhe djegia e mbeturinave në hapësira publike është një problem ekzistues edhe në qytetin e Prizrenit, prandaj shtimi i numrit të inspektimeve dhe shqiptimit të gjobave duhet të realizohet për të pasur një kontrollë më të madhe ndaj këtyre rasteve. Po ashtu, rekomandohet edhe bashkëpunimi me qytetarët duke i informimuar ata që këto veprime janë të jashtëligjshme dhe t'i njoftojnë se çfarë dëme shkaktojnë në mjedis, e poashtu t'i njoftojnë ata se ku duhet të raportojnë nëse janë dëshmitarë të rasteve të tilla.

Problematikë e madhe në nivel vendi ende vazhdon të mbetet deponimi i mbeturinave. Deponia e Landovicës është njëra prej 7 deponive sanitare të Kosovës që menaxhohet nga KMDK (Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës). Në raportin e AMMK-së (Agjicioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës) për vlerësimin e gjendjes mjedisore të Deponisë sanitare në Prizren, të publikuar në qershor 2021, thuhet se jetëgjatësia e kësaj deponie është paraparë të jetë 15 vjet nga fillimi i operimit. Por deponia akoma është në funksion, me gjasë edhe për shumë vite, e sipas këtij raporti të agjencionit, gjendja mjedisore e deponisë nuk është e mirë.

Kjo çështje është ngritur edhe më herët nga EC. Andaj rekomandohen institucionet kompetente që të shqyrtojnë mundësinë për krijimin e një vendi të ri që do të shërben si deponi, mirëpo duke ofruar kushte më të mira se sa kjo e tanishmja.

PËR EC

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikqëyrjes së vendimarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme: 1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshmë statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale, 2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe 3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 - 2024) ka këto elemente: **1. Gjithëpërfshirjen**, **2.Qëndrueshmërinë**, dhe **3. Dijen**. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga posht lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizonare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

- 1. Paanshmëria** - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpëra alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsjon;
- 2. Aktivizmi** - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpëra bashkëveprimin qytetar për të përbushur misionin e organizatës;
- 3. Orientimi drejt rezultateve** - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura;
- 4. Komuniteti bazë e veprimit** - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.